



Raport Vjetor

**“Monitorimi i Decentralizimit në Veprimtarinë e Komisionit
Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të
Drejtat e Njeriut”**

Tiranë, Dhjetor 2011

Ky dokument është një produkt i Departamentit të Qeverisjes Vendore dhe Zhvillimit të Integruar i IDN-së i cili realizohet me mbështetjen financiare të Fondit Think Tank, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur (Budapest, Hungari).

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë të ekspertëve të Departamentit të Qeverisjes Vendore dhe Zhvillimit të Integruar dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

Përgatitur nga:

Autor: Doktorant Enea HOTI

Redaktor: MA. Erisa ÇELA

Departamenti i Qeverisjes Vendore dhe Zhvillimit të Integruar (QVZHI)

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

PERMBAJTJA E LENDES

- I. HYRJE**
- II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT**
- III. GJETJET KRYESORE TE RAPORTIT**
- IV. REKOMANDIME**
- V. ANEKS I**
- VI. ANEKS II**

I. HYRJE

Decentralizimi dhe qeverisja vendore, janë pjesë e rëndësishme e organizimit institucional të shtetit në pjesën ekzekutive të tij, njohur respektivisht edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në një sërë aktesh normative ndërkombëtare dhe ligjore, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria, ka ratifikuar gjithashtu Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, dokument i cili i jep udhën shumë të drejtave të njohura ndërkombëtarisht për njësitë e qeverisjes vendore në shtetet që kanë ratifikuar këtë Kartë. Një nga parimet e rëndësishme të kësaj Karte, është e drejta e NJQV-ve për tu shprehur dhe për t'u marrë mendimi mbi çdo akt normativ që ndikon në çështjet që ju takojnë atyre drejtpërsëdrejti.

Decentralizimi si instrument dhe qeverisja vendore si institucion, duke pasur një rregullim kushtetues dhe baza të forta në marrëveshjet ndërkombëtare, është subjekt i ndryshimeve dhe i rregullimeve me akte normative të karakterit të përgjithshëm në formën e ligjit. Në këtë aspekt, si rregull, çështjet më të rëndësishme për decentralizimin dhe qeverisjen vendore bëhen nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve specifike.

Kuvendi i Shqipërisë, një pjesë të veprimtarisë së tij në procesin e ligjbërjes, por edhe të kontrollit parlamentar, për çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore, ja ka besuar Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KPÇLAPDNJ).

Në këtë kontekst, Departamenti për Qeverisjen Vendore dhe Zhvillimin e Integruar pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim me mbështetjen e OSI Think Tank Fund, ka ndërmarrë gjatë vitit 2011 monitorimin e veprimtarisë së këtij Komisioni, në aspektin që mbulon decentralizimin dhe qeverisjen vendore. Ky monitorim bazohet në një metodologji që ka përcaktuar kritere për të qenë sa më objektiv në nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve përkatëse.

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Metodologjia e përzgjedhur për monitorimin e decentralizimit dhe qeverisjes vendore në veprimtarinë e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KPÇLAPDNJ) bazohet në 6 kritere. Këto kritere objektive bëjnë të mundur vlerësimin nga pikëpamja formale dhe cilësore të veprimtarisë së KPÇLAPDNJ në drejtim të decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Monitorimi preku vetëm atë pjesë të veprimtarisë së Komisionit, që kishte të bënte me decentralizimin dhe qeverisjen vendore. IDN skanoi të gjithë projektligjet e shqyrtuara në KPÇLAPDNJ, gjithsej rreth 79 projektligje të shqyrtuara në 71 mbledhje të këtij komisioni përgjatë periudhës 12 janar- 7 Dhjetor 2011 (*sipas transkriptimit dhe pasqyrimin të procesverbaleve të botuara në faqen e internetit të Kuvendit*) dhe përzgjodhi për monitorim 9 projektligje që i referoheshin decentralizimit dhe qeverisjes vendore të shqyrtuara nga Komisioni në 16 mbledhje të tij¹.

Pra rreth 12% të totalit të projektligjeve të shqyrtuara nga KPÇLAPDNJ, i përkasin projektligjeve me impakt në decentralizim dhe qeverisjen vendore. Ndërkohë, që për 12% të projektligjeve me impakt për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, KPÇLAPDNJ i ka kushtuar atyre 16 mbledhje nga 71 të tilla të zhvilluara, që do të thotë afërsisht 22% të mbledhjeve të zhvilluara.

Përveç aspektit të monitorimit të punës së Komisionit me shqyrtimin e projektligjeve që prekin decentralizimin dhe qeverisjen vendore dhe që konsiderohet pjesë e funksionit ligjvënës të Kuvendit, IDN mori në shqyrtim edhe pjesën e funksionit të kontrollit parlamentar që ky Komision ka bërë në drejtim të decentralizimit dhe qeverisjes vendore, duke marrë nën monitorim atë pjesë të shqyrtimit nga ana e Komisionit të punës së Institucioneve të Pavarura dhe që lidhen me zbatueshmërinë e ligjeve edhe në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore si p.sh. Institucioni i Avokatit të Popullit apo Komisioni i Shërbimit Civil.

Pas skanimit dhe përzgjedhjes së projektligjeve apo raporteve të institucioneve të pavarura monitorimi u bazua në procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit si dokumenti zyrtar bazë që transkripton dhe pasqyron drejtë dhe saktë punën e Komisionit dhe anëtarëve të tij.

Gjithashtu, përgjatë punës me monitorimin e projektligjeve, konstatoam se një sërë projektligjesh me impakt për decentralizimin dhe qeverisjen vendore rreth 8 projektligje, ose 40% e projektligjeve me impakt për decentralizimin dhe qeverisjen vendore të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, janë shqyrtuar nga Komisione të tjera të Kuvendit dhe jo nga KPÇLAPDNJ, që është komision parësor për çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore, gjë që cunon deri diku monitorimin e plotë dhe bëhet imperative për të përmirësuar metodologjinë për monitorimin në vitet në vazhdim².

¹ Lista e projektligjeve të shqyrtuara nga KPÇLAPDNJ dhe të marra nën monitorim jepen në aneksin nr.I.

² Lista e këtyre projektligjeve që nuk janë shqyrtuar nga Komisioni parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për vitin 2011 jepet në aneksin nr II.

Në këtë pikë vlen të përmendet rasti i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” që shfuqizoi taksën e regjistrimit të automjeteve si taksë vendore dhe e kaloi atë në taksë kombëtare.

Ky projektligj nuk është shqyrtuar nga KPÇLAPDNJ, ku përveç impaktit financiar dhe ekonomik mbi njësitë e qeverisjes vendore e cila shqyrtohet nga Komisioni parlamentar për Ekonominë, heqja e një takse vendore nga regjistri i taksave vendore dhe kalimi i saj në regjistrin e taksave kombëtare, prek në thelb vetë konceptin e decentralizimit, çështje kjo që duhet të jetë në diskutim në Komisionin parlamentar të Ligjeve që përgjigjet për qeverisjen vendore.

Në këtë aspekt, Konferenca e Kryetarëve në bashkëpunim me Kryetarin e Komisionit Parlamentar të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut në ndarjen e projektligjeve sipas komisioneve, duhet të tregohen më të kujdesshëm që projektligje të tilla të mos kalojnë pa u shqyrtuar edhe nga Komisioni parlamentar i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

Pra si konkluzion mund të thuhet se projektligje të tilla, që pavarësisht se nga pikëpamja sektoriale i përkasin ekonomisë, mjedisit etj., nga pikëpamja e decentralizimit dhe qeverisjes vendore si çështje ndërsektoriale, duhet të kalojnë për shqyrtim edhe në Komisionin Parlamentar të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

Monitorimi i projektligjeve dhe kontrollit parlamentar për decentralizimin dhe qeverisjen vendore u krye sipas 6 kritereve të përcaktuara si më poshtë, që janë të natyrës formale dhe cilësore:

- 1. Prezenca e anëtarëve të KPÇLAPDNJ në mbledhjet e komisionit;*
- 2. Prezenca e përfaqësuesve të ministrive përgjegjëse për draftin e projektligjeve të paraqitura si dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, si ministria e linjës që ndjek çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore;*
- 3. Prezenca e përfaqësuesve të shoqatave të të zgjedhurve vendore dhe grupeve të tjera të interesit;*
- 4. Cilësia e debateve parë nga këndvështrimi i propozimeve dhe kundërshtimeve (nga anëtarët e KPÇLAPDNJ) në amendimin e projektligjeve apo akteve të tjera;*
- 5. Dëgjimi dhe reflektimi i propozimeve dhe kundërshtimeve (nga përfaqësues të Shoqatave të të zgjedhurve vendorë dhe grupeve të interesit) në amendimin e projektligjeve;*
- 6. Kontrolli parlamentar i ushtruar nga KPÇLAPDNJ për zbatueshmërinë e ligjeve në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore.*

III. GJETJET KRYESORE TE RAPORTIT TE MONITORIMIT

Kriteri 1. Prezenca e anëtarëve të KPÇLAPDNJ në mbledhjet e komisionit;

Veprimtaria e KPÇLAPDNJ gjatë viti 2011 ka reflektuar problematikën politike që ka mbërthyer vendin, në veçanti nëpërmjet bojkotit nga ana e opozitës së pjesëmarrjes në Kuvend.

Mungesa e pjesëmarrjes së deputeteve të opozitës në gati 60% të mbledhjeve ku janë shqyrtuar projektligje me impakt në decentralizimin dhe qeverisjen vendore, ka sjellë një funksionim jo normal të këtij komisioni duke cënuar edhe cilësinë e procesit të ligjvënës si dhe duke mos reflektuar opinionin opozitar mbi çështje të rëndësishme të decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Deputetët e opozitës përkatësisht kanë marrë pjesë në 7 mbledhje nga 16 të tilla, në të cilat janë shqyrtuar projektligje dhe raporte për çështje të decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Ndërkohë që deputetët e maxhorancës kanë qenë prezent në të gjitha mbledhjet e Komisionit, me mungesa të raportuara vetëm në 2 mbledhje me përkatësisht 2 deputetë të maxhorancës që mungonin.

Në këto mbledhje të KPÇLAPDNJ, deputetët e opozitës kanë marrë pjesë në shqyrtimin e vetëm 3 projektligjeve nga 9 të tilla që kanë pasur të bëjnë me decentralizimin dhe qeverisjen vendore ose ndryshe në rreth 35% të projektligjeve të shqyrtuara. Ndërkohë deputetët e maxhorancës kanë marrë pjesë në shqyrtimin e të gjithë 9 projektligjeve ose në 100% të masës së tyre.

Ndërkohë që deputetët e opozitës kanë qenë prezent pjesërisht, gjatë shqyrtimit të raporteve të institucioneve të Avokatit të Popullit dhe Komisionit të Shërbimit Civil.

Deputetët e opozitës kanë marrë pjesë në shqyrtimin e 2 projektligjeve, që në mënyrë të veçantë impaktojnë decentralizimin dhe qeverisjen vendore përkatësisht të:

- 1) Projektligjit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2012;
- 2) si dhe Projektligjin “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;

ndërkohë deputetët e opozitës kanë munguar në shqyrtimin e projektligjit të rëndësishëm “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Kriteri 2. Prezenca e përfaqësuesve të ministrive përgjegjëse për draftin e projektligjeve të paraqitura si dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, si ministria e linjës që ndjek çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore;

Në të gjitha rastet e shqyrtuara të projektligjeve me impakt në qeverisjen vendore dhe decentralizimin është vënë re pjesëmarrja e përfaqësuesve të ministrive apo institucioneve që janë marrë me procesin e përgatitjes së drafteve të projektligjeve të sjella për shqyrtim para KPÇLAPDNJ.

Më konkretisht në 16 mbledhje të zhvilluara përfaqësuesit e ministrive apo institucioneve që janë marrë me procesin e përgatitjes së drafteve të projektligjeve, kanë marrë pjesë në 100% të zhvillimit të tyre.

Kjo ka kontribuar në prezantimin dhe diskutimin cilësor të projektligjeve, që çon natyrshëm në një proces cilësor të ligjberjes, duke i dhënë mundësi komisionit edhe për të zëvendësuar mungesën e kapaciteteve apo njohurive në fushat respektive.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ministrive që kanë përgatitur draftet e projektligjeve mund të themi që është kthyer në një normë obligative për punën e Komisionit.

Nga monitorimi i projektligjeve që janë shqyrtuar nga KPÇLAPDNJ, me impakt në decentralizimin dhe qeverisjen vendore, është konstatuar se në shumicën dërrmuese të rasteve ose rreth 97% të tyre, kanë munguar në mbledhjet e komisionit përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, si ministria e linjës që mbulon çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme kanë marrë pjesë vetëm në 1 mbledhje të KPÇLAPDNJ, gjatë shqyrtimit të projektligjit “Për buxhetin e shtetit për vitin 2012”.

Kjo mungesë, ndikon në thithjen e mendimeve specifike dhe profesionale të përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, e cila presupozohet që është institucioni qeveritar që përmbledh njohuritë maksimale dhe të azhuruara mbi këto çështje, si dhe që ka tagrin për hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave për decentralizimin dhe qeverisjen vendore. Mos shfrytëzimi i këtyre kapaciteteve nga ana e KPÇLAPDNJ, ndikon në përgatitjen e ligjeve cilësore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore, kjo sidomos në aspektin kur draftet e projektligjeve ju nënshtrohen amendamenteve gjatë punës së komisionit.

3. Prezenca e përfaqësuesve të shoqatave të të zgjedhurve vendore dhe grupeve të tjera të interesit.

Ky është kriteri më me peshë në të gjithë kriteret e renditura, nën këndvështrimin e kërkesave që vendos Karta Evropiane e Autonomisë Vendore për dhënien e mundësisë së shprehjes së opinionit dhe dëgjimit të përfaqësuesve të qeverisjes vendore për çështje që i prekin ata drejtpërsëdrejti.

Nga monitorimi për sa i përket nivelit të konsultimit dhe përfshirjes së përfaqësuesve të qeverisjes vendore në mbledhjet e KPÇLAPDNJ, gjatë shqyrtimit të projektligjeve me impakt në decentralizimin dhe qeverisjen vendore, kemi konstatuar se në asnjë rast të shqyrtuar nga procesverbalet e mbledhjeve të KPÇLAPDNJ-së, për 9 projektligje të shqyrtuara në 16 mbledhje të Komisionit, ose në 100% të rasteve, nuk është konstatuar pjesëmarrja dhe prezenca e përfaqësuesve të shoqatave të zgjedhurve vendorë dhe/ose e grupeve të interesit.

Akoma më evident bëhet ky fakt, duke pasur në vëmendje se KPÇLAPDNJ është komisioni i ngarkuar për çështjet e qeverisjes vendore në Kuvendin e Shqipërisë, që presupozon se duhet të jetë komisioni më i predispozuar për të thithur kontributet nga përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe grupeve të interesit.

Në një analizë më të thellë, mund të themi se në mënyrë evidente kemi të bëjmë me një shpërfillje të mbrojtjes së interesave legjitime të qeverisjes vendore në procesin e ligjvënies në KPÇLAPDNJ.

4. Cilësia e debateve parë nga këndvështrimi i propozimeve dhe kundërshtimeve (nga anëtarët e KPÇLAPDNJ) në amendimin e projektligjeve apo akteve të tjera;

Anëtarët e KPÇLAPDNJ, në shumicën e rasteve kur janë shqyrtuar projektligje me impakt në decentralizim dhe qeverisjen vendore, janë përpjekur të diskutojnë dhe të ngrenë shqetësime konkrete në lidhje me problematikën e diskutuar. Megjithatë, vihet re natyrshëm fakti, se në këto diskutime spikasin kryesisht 1 ose 2 deputetë të caktuar që mbizotërojnë në këto diskutime.

Në 8 mbledhje të Komisionit ose në 50% të tyre, deputetët kanë diskutuar me argumente teknike dhe cilësore mbi çështje të impaktit në decentralizim dhe qeverisje vendore. Spikasin veçanërisht diskutimet dhe argumentet teknike të deputetëve kryesisht të opozitës për “Projektligjin për buxhetin e shtetit për vitin 2012” dhe projektligjin “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Vlen të theksojmë se diskutimet e deputetëve për “Projektligjin për buxhetin e shtetit për vitin 2012”, veçanërisht për nenin 15 të projektligjit, e kanë trajtuar mirë çështjen e decentralizimit dhe autonomisë vendore duke bërë reference të qartë në legjislacionin në fuqi që mbron të drejtat e qeverisjes vendore, në raport me autonominë për të shpenzuar të ardhurat e tyre.

Pra në mënyrë të qartë, anëtarë të caktuar të Komisionit të ligjeve, janë të ndjeshëm ndaj çështjes së decentralizimit dhe respektimit të autonomisë vendore. Kjo është një tendencë që duhet përkrahur dhe të përhapet e mbështetet edhe nga anëtarët e tjerë të këtij komisioni.

Në 4 mbledhje të Komisionit ose në 25% të tyre, kur janë shqyrtuar ligjet që prekin decentralizimin dhe qeverisjen vendore, deputetët kanë diskutuar në mënyrë teknike por vetëm pjesërisht për çështje që prekin decentralizimin dhe autonominë e qeverisjes vendore.

Në 1 rast, është vënë re mungesa e çfarëdolloj diskutimi të natyrës qoftë teknike apo politike nga ana e deputetëve për impaktin në decentralizim dhe qeverisjen vendore përgjatë shqyrtimit të projektligjit “*Për legalizimin e kapitalit, dhënien e amnistisë për disa vepra penale dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor*” për pjesën referuese të biznesit të vogël, që kontribuon me taksat e tij në të ardhurat e buxheteve vendore.

Nga njëra anë, diskutimet konkrete kontribuojnë në cilësinë e projektligjeve të shqyrtuar, por nga ana tjetër kufizimi i diskutimeve vetëm në 1 ose 2 deputetë të caktuar, evidentojnë mungesën e kapaciteteve të anëtarëve të komisionit për të trajtuar çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore si dhe thekson edhe një herë nevojën për përfshirjen e kontributeve më të specializuara në procesin e ligjbërjes, qoftë nga ana e ekspertëve të Ministrisë së Brendshme qoftë edhe të përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe grupeve të interesit.

5. Dëgjimi dhe Reflektimi i propozimeve dhe kundërshtimeve (nga përfaqësues të Shoqatave të të zgjedhurve vendorë dhe grupeve të interesit) në amendimin e projektligjeve;

Ky kriter, lidhet me kriterin e mësipërm nr. 3, të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqatave të të zgjedhurve vendorë dhe grupeve të interesit, në kuptimin që nëse edhe formalisht nuk është përmbushur ai kriter, pra nuk është garantuar pjesëmarrja formale, atëherë ky kriter mbetet nul, pasi nuk mund të dëgjohen dhe të reflektohen propozimet apo kundërshtimet e përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe grupeve të interesit, nëse *minimalisht* nuk janë prezentë gjatë zhvillimit të mbledhjeve të komisionit.

Pra në *100% të rasteve* të shqyrtimit të projektligjeve me impakt në decentralizim dhe qeverisje vendore nuk është dëgjuar dhe reflektuar mendimi i përfaqësuesve të shoqatave të të zgjedhurve vendorë dhe grupeve të interesit.

Edhe në këtë aspekt, mund të themi që veprimtaria e komisionit në këtë kriter nuk ka kontribuar për një proces cilësor të ligjbërjes, që passjell si rezultat një zbatueshmëri të ulët të ligjeve në një moment të dytë, çështje e cila evidentohet në të gjitha raportet e BE-së, si një nga problemet më të mëdha të Shqipërisë.

Në këtë kontekst, veprimtaria e KPÇLAPDNJ nëpërmjet mospërfshirjes së përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe grupeve të interesit në procesin e ligjbërjes, kontribuon në uljen e funksionalitetit të ligjeve dhe zbatueshmërisë së tyre.

Përpos kësaj, mospërfshirja e përfaqësuesve të qeverisjes vendore në procesin e ligjbërjes për çështjet që prekin ata në mënyrë të drejtpërdrejtë, çon edhe në uljen e imazhit të Shqipërisë në drejtim të zbatimit të obligimeve që rrjedhin nga Karta Evropiane e Autonomisë Vendore.

6. Kontrolli parlamentar i ushtruar nga KPÇLAPDNJ për zbatueshmërinë e ligjeve në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Ky kriter i monitorimit, i përket atij funksioni të KPÇLAPDNJ, që lidhet me kontrollin parlamentar të fushave që komisionet parlamentare mbikëqyrin, në këtë rast të qeverisjes vendore, midis të tjerave për zbatueshmërinë e legjislacionit.

Nën këtë kriter, Komisioni ka ushtruar këtë përgjegjësi përgjatë shqyrtimit të raportit të punës së institucioneve të pavarura vetëm në dy raste, që i përkasin shqyrtimit të Raportit Vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit dhe shqyrtimit të Raportit Vjetor të institucionit të Komisionit të Shërbimit Civil.

Në të dyja rastet e evidentuara, KPÇLAPDNJ ka bërë ndërhyrje dhe pyetje konkrete që i përkasin punës së këtyre institucioneve me njësitë e qeverisjes vendore, në aspektet funksionale dhe sipas kompetencave ligjore që mbulojnë këto institucione. Ky lloj aktiviteti dhe mënyre e mbikëqyrjes nga ana e KPÇLAPDNJ, kontribuon në përmirësimin e punës së këtyre institucioneve në drejtim të marrëdhënieve me njësitë e qeverisjes vendore.

Nga ana tjetër, kontrolli parlamentar nga ana e KPÇLAPDNJ për çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore duhet jetë i një natyre më aktive dhe më të drejtpërdrejtë, duke zgjeruar hartën e institucioneve dhe subjekteve, që raportojnë përpara këtij komisioni specifikisht për çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

IV. REKOMANDIME

Në përgjithësi vërehet kujdesi, për të trajtuar dhe mos anashkaluar diskutime cilësore të natyrës teknike, në rastet kur projektligjet prekin çështje të decentralizimit dhe autonomisë së qeverisjes vendore, sidomos në rastin e 1 ose 2 anëtarëve të Komisionit, që spikasin me aktivizimin dhe kapacitetet e tyre në këtë fushë.

Megjithatë, në opinionin tonë disa aspekte të punës dhe veprimtarisë së KPÇLAPDNJ për procesin e ligjbërjes me impakt në decentralizimin dhe qeverisjen duhen përmirësuar ndjeshëm. Kjo mbetet imperative sidomos në çështjen e përfshirjes në këtë proces të sa më shumë kontributeve, si nga Ministria e Brendshme ashtu edhe nga përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe grupeve të interesit, që i japin tonin e duhur një procesi ligjbërës sa më demokratik dhe transparent.

Në kontekstin e monitorimit sipas kritereve të sipërpërmendura, disa rekomandime specifike lidhen me përmirësimet e nevojshme. Më konkretisht:

1. Komisionit Parlamentar të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut i sugjerojmë, që të kthejë në një praktikë pune (ose normë detyruese për projektligje të rëndësishme, që prekin thelbin e funksioneve dhe kompetencave të qeverisjes vendore dhe procesit të decentralizimit), përfshirjen e përfaqësuesve të shoqatave të të zgjedhurve vendor dhe grupeve të interesit në mbledhjet e komisionit, në rastet e shqyrtimit të projektligjeve me impakt në çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore. Kjo do të përmirësonte në mënyrë evidente cilësinë e projektligjeve të miratuara dhe zbatueshmërinë e tyre në mënyrë efikase dhe funksionale.
2. Sugjerohet pjesëmarrje e plotë e deputetëve në mbledhjet e komisionit, sidomos të deputetëve përfaqësues të opozitës parlamentare, me qëllim për të siguruar diversitetin e diskutimeve mbi projektligjet me impakt në decentralizim dhe qeverisjen vendore, për sa kohë këto çështje gjejnë rregullim në Kushtetutën e RSH, Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjeve organike të miratuara me 3/5 e anëtarëve të Kuvendit të RSH, që i bën këto çështje subjekt i vullnetit dhe konsensusit politik bipartizan.
3. Sugjerojmë, që KPÇLAPDNJ të ketë më shumë përfshirje në shqyrtimin e projektligjeve që prekin decentralizimin dhe qeverisjen vendore, si komision parësor që mbulon këtë fushë, krahasimisht me punën e komisioneve të tjera parlamentare kur projektligjet e shqyrtuara janë të një rëndësie me impakt të qenësishëm në qeverisjen vendore si psh. ndryshimet në ligjin për taksat vendore, ligjin për mbrojtjen e mjedisit, ligjin për lejet mjedisore, për menaxhimin e integruar të mbetjeve, etj³.

³ Lista e këtyre projektligjeve që nuk janë shqyrtuar nga Komisioni parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për vitin 2011 jepet në aneksin nr II.

Ky rekomandim mbetet në veçanti për t'ju sugjeruar Konferencës së Kryetarëve dhe Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, përgjatë ndarjes përkatëse të punës për Komisionet respektive.

4. KPÇLAPDNJ, në mungesë të kapaciteteve specifike për çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore, të ftojë në mbledhjet e komisionit, në rastet e shqyrtimit të projektligjeve me impakt në çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, përveç praktikës së mirë konsoliduar tashmë, të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Ministrive që kanë përgatitur draftet e projektligjeve.
5. Kontrolli parlamentar për çështjet e decentralizimit dhe qeverisjes vendore sugjerojmë të ushtrohet direkt, edhe nëpërmjet thirrjes për dëgjesa publike të përfaqësuesve të qeverisjes qendrore, qeverisjes vendore, shoqatave dhe grupeve të interesit, veçanërisht për çështje të zbatimit të legjislacionit në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore.
6. Mbetet shumë e këshillueshme, parashikimi i formave adekuate të trajnimit të deputetëve anëtarë të KPÇLAPDNJ, si vizita studimore, seminare dhe konferenca për thellimin e njohurive dhe zgjerimin e kapaciteteve, në drejtim të çështjeve të decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Kjo, me synim që të arrihet një përfshirje më e plotë e të gjithë deputetëve anëtarë të komisionit në diskutimet për shqyrtimin e projektligjeve për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, përtej 1 ose 2 deputetëve që janë shumë aktivë. Një rast i mirë do të ishte njohja nga afër e deputetëve anëtarë të KPÇLAPDNJ, me punën dhe veprimtarinë e Këshillit të Evropës dhe Kongresit të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale të Këshillit të Evropës me seli në Strasburg, në kuadrin e të cilave është miratuar edhe Karta Evropiane e Autonomisë Vendore.

ANEKS I

Projektligje të monitoruara:

1. Projektligji “Për të drejtën e kalimit në pronë të shtetit dhe private, për ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike”.
2. Projektligji “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.
3. Projektligji “Për legalizimin e kapitalit, dhënien e amnistisë për disa vepra penale dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”.
4. Projektligji “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”
5. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, të ndryshuar”.
6. Projektligji “Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar”.
7. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore” të ndryshuar”
8. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.”
9. Projektligji “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012”.

Raporte të monitoruara:

1. Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2010.
2. Raporti vjetor për veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2010

ANEKSI II

Ligje me impakt në decentralizim dhe qeverisjen vendore, që nuk kanë qenë objekt shqyrtimi nga Komisioni parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut por objekt shqyrtimi i komisioneve të tjera parlamentare:

1. Ligj Nr.10 389, datë 3.3.2011, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9668, datë 18.12.2006 “Për migrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”.
2. Ligj nr.10 399 datë 17.3.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, date 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar.
3. Ligj nr.10 431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
4. Ligj nr.10 434 datë 23.6.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
5. Ligj nr.10 440 datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
6. Ligj nr.10 457 datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
7. Ligj nr.10 463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
8. Ligj nr.10 465 datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”.